



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Përmirësuar: Më/Dana 13.12.2017 vit/god.			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednosit
02-035/02-1003			



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta Zyrtare nr. 28/2008, neni 51 paragrafi 1 të Statutit të komunës së Vitisë nr. 01-013/491 të datës 21.04.2011 në përputhje me Rregulloren e aprovuar në Kuvendin Komunal të datës 23.12.2016 me numër protokollit 01-013/1706, Kryetari i Komunës bie këtë:

VENDIM PËR NDARJEN E MJETEVE FINCIARE NË SHUMË PREJ 370.00€ OJQ “Legjenda”

I.

Me këtë Vendim, Kryetari i Komunës së Vitisë **NDAN** mjete financiare në shumë prej **370.00€** me shkronja (treqind e shtatëdhjetë euro), OJQ “Legjenda” në emër të mbështetjes financiare për zhvillimin e aktivitetit të kësaj shoqate për (Organizimin e Ekspozitës Tradicionale të fotografisë në partneritet me shoqaten e artistëve).

II.

Mjetet nga neni 1 i këtij Vendimi, sigurohen nga Buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2017 nga kodi buxhetor për subvencione dhe transfere i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport. Shuma e mjeteve prej 370.00 € derdhet në llogarinë e OJQ “Legjenda”. Obligohet Drejtori financiarë i OJQ Legjenda të paraqes raportin me shkrim të mjeteve të shpenzuara nga neni 1 i këtij vendimi te Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Vitisë

III.

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport si dhe Zyra e Thesarit e Komunës së Vitisë

IV.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kryetarit të Komunës së Vitisë

Drejtori i DKRS-së
Milot LALA

Kryetari i Komunës së Vitisë
z. Sokol HALITI

Vendimi u dorëzohet

1. OJQ “Legjenda”
2. Drejtorisë për Kulturë, rini dhe Sport
3. Zyrës së Thesarit dhe
4. Arkivit

